



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR

DEKLARATË

**E TRUPËS GJYQËSORE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**

Trupa gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër shpreh tronditjen e thellë dhe indinjatën e saj për ngjarjen e rëndë që i mori jetën gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. Astrit Kalaja.

Kjo ngjarje tragjike është një këmbanë alarmi për situatën e sigurisë me të cilën përballen sot gjyqtarët dhe institucionet e drejtësisë në vendin tonë. Mungesa e mbrojtjes së duhur, denigrimi i figurës së gjyqtarit dhe mosrespektimi i autoritetit gjyqësor janë dukuri shqetësuese që çënojnë thellësisht jo vetëm individët që i shërbejnë këtij sistemi, por edhe besimin e qytetarëve në drejtësinë shqiptare.

Trupat gjyqësore ushtrojnë detyrën me përkushtim, integritet dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, në një nga funksionet më themelore dhe më delikate të shtetit të së drejtës. Ato meritojnë mbështetje institucionale, respekt nga publiku dhe, mbi të gjitha, garanci të plota sigurie, në mënyrë që të kryejnë misionin e tyre në kushte që garantojnë pavarësinë dhe integritetin e procesit gjyqësor.

Shteti ka detyrimin ligjor dhe moral për të mbrojtur jetën dhe punën e çdo gjyqtari. Vetëm në këtë mënyrë drejtësia mund të përmbushë misionin e saj të shenjtë në një shoqëri demokratike.

Në këto momente të dhimbshme, Trupa Gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër i përcjell ngushëllimet më të sinqerta familjes së të ndjerit, kolegëve si dhe gjithë komunitetit të drejtësisë për këtë humbje të pazëvendësueshme.

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR**